



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 24.02.2012, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Emin Gërbeshi

Mungoi: Rexhep Selimi, Ganimete Musliu, Anton Quni dhe Rasim Demiri
Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 06.02.2012 dhe 10.02.2012
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtarë për Projektligjin nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtarë për Projektligjin nr. 04/L-89 për Deminimin humanitar;
5. Shqyrtimi i Ligjit për Policinë;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 06.02.2012 dhe 10.02.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, miratoi Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur më 06.02.2012 dhe 10.02.2012 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtarë për Projektligjin nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryetari i Komisionit- Miratimi i këtij Raporti e bëjmë për të dytën herë për shkak të vonesës në Komisionin për Komunitete dhe pastaj Raporti kalon në seancë.

Fatmir Xhelili- Projektligji i plotëson të gjitha kriteret për të kaluar në lexim të dytë mirëpo duhet të vendoset për vërejtjen e bërë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa për dy Amendamentet gjatë shqyrtimit të nenit 5 dhe neni 27 të këtij projektligji.

Neni 5, Amendamenti 1, në paragrafin e tretë duhet të fshihet pjesa përfundimtare që është “*përveç pagesës financiare për kategoritë e invalidëve të luftës*” pasi në bazë të llogaritjeve nga Ministria e Financave dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar qëllimi është të hiqet kjo pjesë, Amendamenti i parë.

Në nenin 27, Amendamenti 11. Në nenin 27 shtohet paragraf i ri me këtë tekst “ *në masën që qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të parapara fiskale në buxhetin publik që të siguroj ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin që të që të lëshoj vendim që redukton çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesën financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit për buxhetin të aplikueshëm në atë kohë*”

Kjo do të thotë që, nëse dikush ka përfituar beneficione të tjera nga ligjet në fuqi Qeveria do të ketë të drejtën të reduktoj këto beneficione duke u thirrur në këtë ligj ose përcaktimi për beneficionet që parashihen nga ligjet e tjera.

Nur Çeku- Forma e amendamenteve nuk është e saktë nga ana juridike. Ky amendament sipas Komisionit për Buxhet dhe Financa është propozuar nga FMN-ja. Komisioni duhet të bëjë një amendament tjetër që e përkrah ose jo amendamentet e paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Fatmir Xhelili- Nga puna e bërë për këtë projektligj, neni 27 do të mund të mbetej ashtu siç ishte që Qeveria do të jetë garant për të gjitha pensionet pavarësisht lartësisë së saj në fazat e zhvillimeve buxhetore.

Propozoj që ky Amendament mos të përfshihet në këtë projektligj, por nëse vjen si detyrim nga FMN-ja do duhej të vinte në formë të shkruar pasi me këtë amendament i mundëson qeverive eventuale të bëjnë reduktime të pensioneve edhe pse kjo gjë është e paraparë me skemën pensionale bazuar në fondin ekzistues të ndara për pensionet. Kjo formë e formulimit nuk është e pranueshme pasi lejon hapësirë për keqinterpretime.

Goran Marinković- Neni 27 është i qartë dhe në paragrafin e ri shihet që Qeveria në disa raste i heq pensionet që i kanë pasur më parë

Kryetari i Komisionit- Konsideroj që neni 5 paragrafi 3 është i qartë dhe nuk mendoj që përfshirja e amendamentit të propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa është e drejtë duke i dhënë autorizime Qeverisë për reduktime eventuale, pasi me ligj është shprehur qartë që përfitohet ai lloj i caktuar i pensioneve, citoj paragrafin 3” përveç pagesës financiare për kategoritë invalidëve të luftës” dhe nuk është e nevojshme angazhimi i Qeverisë me këtë amendament pasi ky është i përgjithësuar dhe propozoj që Amendamentet të kalojnë në seancë pa përkrahjen e Komisionit.

Gjithashtu në nenin 27 citoj” Qeveria e Kosovës do të garantoj realizimin e të drejtave për të gjitha llojet e pensioneve të përcaktuara me ligj” dhe nuk është e nevojshme amendament që i jep obligime shtesë Qeverisë pasi në bazë të këtij ligji Qeveria e ka obligim garantimin e pensioneve. Arsyetimin e këtij Amendamenti duhet ta bëjë Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa kur do të paraqitet në seancë Raporti.

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti me amendamente i raportuesit

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa me përveç amendamentit 11 cito, i cili nuk përkrahet nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe mbikëqyrje të FSK-së.

Vjollca Krasniqi- Në Raport duhet të bëhen përmirësime teknike në emërtimin e Institucionit që e ka hartuar këtë projektligj.

Projektligji është konsideruar që ka ndikim buxhetor bazuar në deklaratën e Komisionit dhe për këtë gjë kemi kritikuar projektligjet e paraqitura në Kuvend që kanë implikime buxhetore dhe në lidhje me këtë a do të përmendet edhe amendamentet që janë propozuar nga FMN-ja, Komisioni për buxhet dhe Financa?

Fatmir Xhelili- Për këtë ligj kemi pajtimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Ministrisë së Financave për planifikimin buxhetor për tre vjetët e ardhshme bashkë me dinamikën e atyre që do të pensionohen në tre vitet e ardhshme . Për pensionimin e ish pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë për tre vjetet e ardhshme ekzistojnë mjetet e siguruar dhe kjo ka qenë në pasqyrën për planifikimin buxhetor gjatë trajtimit të ligjit.

Vjollca Krasniqi- Nëse ekziston një planifikim i tillë Ministria e Financave duhet të deklaroj që nuk ka shtesë buxhetore për këtë fazë kohore në mënyrë që mos ti lihet një kompetencë e tillë Komisionit, anëtarëve të Komisionit pasi nga Raporti kuptohet që ka implikime buxhetore dhe nuk i referohet faktit që Komisioni ka biseduar me përfaqësuesit e Ministrisë së financave.

Fatmir Xhelili- Është bërë prezantimi i pasqyrës nga Ministria e Financave duke përfshirë edhe numrin e pjesëtarëve që do të pensionohen për vitin 2012, 2013 dhe, 2014 pra është një dinamik e planifikuar bashkë me mjetet për ta realizuar.

Goran Marinkoviq- Mbështes miratimin e Amendamentit të 5-të.

Kryetari i Komisionit- Referuar në Raport thuhet që *“Projektligji vlerësohet me ndikime buxhetore në buxhetin e Republikës së Kosovës duke prodhuar kosto shtesë buxhetore”* Duke qenë se ky buxhet është i planifikuar pasi dihet numri i atyre që do të pensionohen teksti mbetet ky që është për tu prezantuar në Kuvend.
Aprovimi i projektligjit pa asnjë vote kundër nga anëtarët e Komisionit

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtarë për Projektligjin nr. 04/L-89 për Deminimin humanitar

Kryetari i Komisionit- Fjalën ia kaloi z. Fatmir Xhelili në emër të grupit punues për këtë projektligj.

Fatmir Xhelili- Grupi punues e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka propozuar gjashtë amendamente dhe plotëson kriteret për të kaluar në lexim të dytë.
Sugjeroj që si Komision të trajtohet titulli i këtij ligji, të mbetet me emërtimin që ka apo të ndryshohet nga Ligji për Deminimin Humanitar në Ligji për Deminim Humanitar kjo sipas ekspertëve të gjuhës.
Ndërsa për Amendamentet propozoj që të përkrahen pasi edhe janë të natyrës teknike.

Kryetari i Komisionit- Meqenëse kemi të bëjmë me formulim gjuhësor konsideroj që është e pranueshme të bëhet ky ndryshim nga Projektligji për Deminimin humanitar në Projektligji për Deminim humanitar dhe është në trajtën e duhur.

Vjollca Krasniqi- Pajtohem që emërtimi të jetë Projektligji për Deminim humanitar dhe jo Projektligji për Deminimin humanitar dhe është mirë të përmirësohet në këtë fazë.

Kryetari i Komisionit- Pyeti të pranishmit nëse kanë vërejtje për Raportin, pas kësaj Komisioni nxori këtë përfundim.

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti me amendamente i raportuesit

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr. 04/L-89 për Deminim Humanitar me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Ligjit për Policinë

Kryetari i Komisionit- Në mungesë të kryesuesit të grupit z. Rexhep Selimi, do të jap sqarimet për këtë projektligj. Grupi punues e ka harmonizuar tekstin e projektligjit nga vërejtjet që janë bere nga Presidentja me vlerësimin në Komisione së arsyetimet që janë dhënë në pjesën shpjeguese për neve si Komision janë të pa pranueshme pasi kanë qenë politike, ndërsa amendamentet e propozuara nga Presidentja janë ri formuluar.

Propozoj aprovimin e amendamenteve të cilat janë përmirësuar në bazë të vërejtjes së Presidentes .

Amendamenti 1, neni 3, pas paragrafit 1.2 formulohet nën paragrafi i ri me këtë përmbajtje” drejtorët e departamenteve nënkuptojnë drejtorët e departamenteve të cilët udhëheqin njëren nga fushat e caktuara të nivelin qendror të Policisë së Kosovës”

Amendamenti u miratua pa vërejtje.

Amendamenti 2, neni 3, paragrafi 1.3 riformulohet si vijon “ zëvendësdrejtorët e përgjithshëm nënkupton zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

Amendamenti u miratua pa vërejtje.

Amendamenti 3, neni 32, paragrafi 2, fjalia e fundit në tekstin e nenit” po ashtu duhet të ketë edhe stacione të policisë kufitare nën juridiksionin qendror të drejtorisë së përgjithshme të policisë, fshihet nga teksti i projektligjit”

Amendamenti u miratua pa vërejtje.

Amendamenti 4, neni 32, pas paragrafi 3 formulohet paragraf i ri me këtë përmbajtje” me qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve përveç stacioneve policore që gjenden në secilin komunë themelohen edhe stacione policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare”

Me këtë formulim jemi pajtuar me grupin punues.

Fatmir Xhelili- Propozoj që fjala themelohet të zëvendësohet me fjalën menaxhohet pasi mund të keqinterpretohet, pasi me këtë term kuptohet që do të themelohen stacione të reja dhe gjithherë varën nga vlerësimi i policisë kufitare se kur është e nevojshme themelimi i një stacioni policor.

Kryetari i Komisionit- Pyeti të pranishmit se a janë dakord që fjala themelohet të zëvendësohet me fjalën menaxhohet?

Emin Gërbeshi- Aspekti logjik është në rregull pasi është me qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve, që do të thotë se emërtimi “me qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve përveç stacioneve policore që gjenden në secilin komunë themelohen edhe

stacione policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare” është korrekt dhe nuk është e nevojshme të ndryshohet dhe është në rregull.

Kryetari i Komisionit- Reformulimi për këtë pjesë mund të bëhet në këtë mënyrë “mund të themelohen edhe stacione policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare” pasi nëse e lejmë vetëm themelohet atëherë krijojmë obligim për themelimin e stacioneve të tjera.

Fatmir Xhelili- Pika e kundërshtimeve ka qenë se me formulimin e më hershëm që përfshin amendamentin 3, është menduar që policia e stacioneve kufitare dhe pikat kufitare drejtpërdrejtë i menaxhon qendra, ndërsa për të treguar që Policia ka një shtyllë për kufi dhe që është Policia Kufitare, ku ekziston qendra dhe drejtoritë rajonale, qëllimi ka qenë për të treguar që ekziston një zinxhir vertikal komandues nga qendra, drejtoritë rajonale dhe stacionet e policive kufitare.

Qëllimi është përcaktimi i drejtorive rajonale për menaxhimin e policisë kufitare dhe kjo është esenca dhe jo themelimi i stacioneve policore pasi në varësi të periudhave të ndryshme kohore pas vlerësimeve, policia ka të drejtë të themeloj stacione policore ose shuarjen e atyre ekzistuese.

Kryetari i Komisionit- Formulimi për pjesën” mund të themelohen edhe stacione policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare” pasi nëse e lejmë vetëm themelohet atëherë krijojmë obligim për themelimin e stacioneve të tjera.

Fatmir Xhelili- Propozoj që propozimi i z. Anton Quni nga grupi punues për këtë pjesë të përfshihet dhe ky është” drejtorja e përgjithshme ushtron juridiksionin e saj në policinë kufitare nëpërmjet drejtorive rajonale”

Këshilltari i Kryetarit të Komisionit, Naim Hoxha- Çështja ka qenë sqarimi i zinxhirit komandues. Drejtorja e përgjithshme ushtron juridiksionin e saj jo vetëm në policinë kufitare por në të gjithë policinë përmes rajoneve të veta dhe është e sqaruar përgjegjësia e drejtorit të përgjithshëm i cili ka përgjegjësi për themelimin e stacioneve dhe nën stacioneve në bazë të nevojave.

Për policinë kufitare, në mënyrë që mos të ndahet nga pjesët e tjera të policisë propozoj që të mbetet teksti i njëjtë ose të shtohet fjala *mund, pra*” mund të themelohen edhe stacione policore kufitare nën autoritetin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare”

Fatmir Xhelili- Propozoj që kjo pjesë e nenit të formulohet në këtë mënyrë: me qëllim të kontrollit të kufijve përveç stacioneve policore që gjenden në secilën komunë menaxhohen edhe stacionet policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare.

Qëllimi i këtij neni nuk ka qenë përcaktimi i hierarkisë së policisë kufitare pasi ajo ekziston por për hir të procesit të liberalizimit për të treguar që policia kufitare ka hierarki

të caktuar dhe se drejtoritë rajonale janë përgjegjëse për menaxhimin e stacioneve policore dhe kufitare dhe ky është qëllimi i këtij neni.

Kryetari i Komisionit- Pasi përmbajtja e nenin me propozimet është e njëjtë propozoj që neni 32, paragrafi 3 të mbetet ashtu siç është propozuar nga Presidentja pa ndonjë ndryshim nga Komisioni.

Me pajtimin e anëtarëve të Komisionit, Amendamenti 4, neni 32, pas paragrafit 3 riformulohet paragrafi i ri me këtë përmbajtje” me qëllim të menaxhimit dhe të kontrollit të kufijve përveç stacioneve policore që gjenden në secilën komunë themelohen edhe stacione policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e drejtorisë rajonale të policisë kufitare”

Në Amendamentin 5, neni 37, paragrafi 6-të riformulohet si vijon” drejtorët e departamenteve duhet të zgjidhen nga drejtori i përgjithshëm në bazë të procedurave të brendshme të policisë së Kosovës”

Ky amendament u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Përveç kësaj do të jap edhe shpjegimet e dhëna nga grupi punues për Projektligjin për Policinë e Kosovës, në të dy elementet që Presidentja ka bërë vërejtje.

E para ka të bëjë me nivelin komandues, nga Drejtori i Përgjithshëm, dy zëvendës drejtorët dhe Drejtorët e Departamenteve.

Nga grupi punues është bërë një formulim i cili është kundërshtuar nga Presidentja, dhe grupi punues është vendosur që hierarkia të mbetet siç vijon, Drejtori i Përgjithshëm, dy zëvendës Drejtorët dhe Drejtorët e Departamenteve.

Elementi i dytë në të cilin është bërë vërejtje nga Presidentja ka qenë për Policinë Kufitare, në grupin punues është shqyrtuar dhe është rënë dakord për Amendamentet që u propozuan në këtë mbledhje.

Kryetari pyeti anëtarët e Komisionit që a janë dakord që me këto Amendamente të procedohet në Kuvend në seancën e radhës?

Të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit votuan pro këtij propozimi.

6. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Ju njoftoj që në cilësinë e Kryetarit të Komisionit jam takuar me Kryetarin e Komunës së Bujanocit z. Shaip Kamberi dhe Kryetarin e Këshillit Kombëtar z. Galip Beqiri dhe kemi biseduar për pozitën e popullatës shqiptare që jeton në Luginën e Preshevës, për lëvizjen e lirë dhe policat e sigurimit që këta duhet të paguajnë kur kalojnë kufirin e Kosovës dhe jemi dakorduar që Qeveria e Kosovës, Institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për pozitën e tyre atje në mënyrë që pozita e tyre të

jetë e përcaktuar me normat ndërkombëtare dhe një përkujdesje më të madhe ashtu siç shteti i Serbisë përkujdesët për minoritetin serb në Kosovë.

Njoftim tjetër është për vizitën studimore të Komisionit në Gjermani, kërkoj nga anëtarët e komisionit që të përcaktohen për këtë vizitë për çështje të organizimit sa më të mirë. Mbështetësit e kësaj vizite Ambasada Gjermane në Kosovë, GIZ-i, janë treguar bujar për vizitën studimore, duke i marrë parasysh sugjerimet e tona për këtë vizitë. Do të vizitohet Bundestagu gjerman, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të brendshme dhe qendrat e trajnimeve.

Goran Marinković- Jam i interesuar të di mbi natyrën e kësaj vizite të përfaqësuesve të Bujanocit. A ka qenë e karakterit zyrtar apo privat dhe a është bërë kërkesë nga ana e tyre që të kenë takim me Komisionin për pozitën e tyre në Serbi?

Kryetari i Komisionit- Këta përfaqësues kanë kërkuar takim me Kryetarin e Komisionit, pasi çdo përfaqësues i ndonjë institucioni që kërkon takim ne jemi të hapur, u kam treguar për punën që bëjmë si Komision dhe për gjendjen e sigurisë në vend, pa e politizuar këtë takim.

Goran Marinković- Për këtë vizitë është dashur të informohet paraprakisht dhe mendoj që ka tendenca politike rreth kësaj.

Kryetari i Komisionit- Pas kthimit nga vizita studimore në Gjermani, në Kosovë nga 3 deri më 6 prill është vizita e delegacionit hungarez nga Komisioni homolog. Do të përgatitem në mënyrën më të mirë në mënyrë që të vazhdoj ky bashkëpunim me Komisionet homologe me vendet e ndryshme.

Gjithashtu ju njoftoj që vërejtjet që kemi pasur për Memorandumin e nënshkruar mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së FSK-së, i kanë bërë ndryshimet e sugjeruara nga Komisioni.

Me këtë informacion e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi